**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

# V E N D I M

Nr.2, datë 5.2.2007

**PËR**
**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.5, DATË 27.2.2003 "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE TË NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.7, DATË 21.3.2005 DHE VENDIMIN NR.17, DATË 27.3.2006**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32, gërma "ç", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.5, datë 27.3.2003 "Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore", të ndryshuar me Vendimin Nr.7, datë 21.3.2005 dhe vendimin Nr.17, datë 27.3.2006, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Pika 2 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.17, dt.27.3.2006 të riformulohet si vijon:
   "Struktura organizative e Drejtorise së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore nga 99 punonjës bëhet 100, sipas aneksit Nr.1 bashkëngjitur këtij Vendimi".

2. Efektet financiare që rrjedhin nga ndryshimi i strukturës së Drejtorise së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore do të përballohen nga buxheti i vitit 2007.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**

**ANEKSI 1**

## STRUKTURA E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

| EMËRTIMI | NUMRI I PUNONJËSVE |
|---|---|
| **Drejtoria e Përgjithshme** | **14** |
| *Drejtori* | 1 |
| – Sekretar i Drejtorit të Përgjithshëm | 1 |
| – Sektori Juridik | 1+2 |
| – Sektori i Regjistrit Vendor | 1+2 |
| – Sektori i Auditimit të Brendshëm | 1+2 |
| – Sektori i Burimeve Njerëzore | 1+2 |
| **Drejtoria e Taksave dhe Tarifa Vendore** | **60** |
| *Drejtori* | 1 |
| – Sektori i të ardhurave nga Taksat dhe Tarifat Vendore | 1+14 |
| – Sektori i Kontrollit te Taksave dhe Tarifave Vendore (Zona A) | 1+22 |
| – Sektori i Kontrollit të Taksave (Zona B+C) | 1+20 |
| **Drejtoria e Administrimit Financiar** | **26** |
| *Drejtori* | 1 |
| – Sektori i Mardhënieve me Debitorët dhe Agjentët Tatimorë | 1+9 |
| – Sektori i Financës dhe Arka | 1+14 |
| **Totali** | **101** |